



1-6 PRILL

JAVA E MBROJTJES

SHQIPËRIA, 16 VJET NË NATO

Në përvjetorin e 16-të të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, kryeministri **Edi Rama** evidentoi reformat e ndërmarra për modernizimin dhe forcimin e dinjitetit të Forcave të Armatosura, duke nxjerrë në pah **sfidat** e kaluara gjatë viteve. Ministri i Mbrojtjes, **Pirro Vengu**, vlerësoi punën, përpjekjet dhe **sakrificat** e çdo efektiv të Forcave të Armatosura. Në fushën e bashkëpunimit politik për **sigurinë** dhe mbrojtjen në rajon, Vengu theksoi se Shqipëria ka treguar **aftësinë** për të **udhëhequr** iniciativa që kontribuojnë në stabilitetin dhe integrimin euroatlantik.

★★★★★



KURSANTËT E KLSM NË KOSOVË

Pjesëmarrësit e Kursit të Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen zhvilluan një vizitë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ku u pritën nga Kryetari, z. Glauk Konjufca. Gjatë takimit u diskutua mbi rëndësinë e këtij kursi si niveli më i lartë i arsimit ushtarak në FARSH, rolin e tij në edukimin dhe kualifikimin e personelit ushtarak dhe civil, si dhe kontributin e tij në forcimin e kapaciteteve kombëtare në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E MBROJTJES

MARITIM
Hotel Plaza Tirana



SHQIPËRIA KRYESON TAKIMIN E 53- TË MAG

Më 27 mars 2025, në Tiranë u zhvillua **takimi** i 53-të i Grupit Këshillimor Shumëpalësh (**MAG**) të Qendrës për Bashkëpunim për Siguri “**RACVIAC**”. Shqipëria, si vend kryesues për vitin 2024–2025, mirëpriti **përfaqësues** nga vendet anëtare dhe **partnere**, ndër to SHBA, Gjermania dhe Austria. Takimi u drejtua nga ambasadorja **Ardiana Hobdari** dhe u përqendrua në rritjen e **bashkëpunimit** rajonal për siguri dhe paqe. U miratuan konkluzionet për aktivitetet dhe **angazhimet** e ardhshme të qendrës me seli në Zagreb, Kroaci.

★★★★★

DRAFTI FINAL PËR EMERGJENCAT CIVILE NË FIER

Nën drejtimin e Prefektit të Qarkut Fier dhe në prani të Drejtorit të Përgjithshëm të AKMC-së, u prezantua drafti final i Planit për Emergjencat Civile të Qarkut Fier, hartuar nga ekspertët e ICLA&GRI dhe mbështetur nga UNDP. Me miratimin e tij përmbillet projekti RESEAL, i zbatuar që nga viti 2022 në gjashtë bashki dhe në prefekturë, duke synuar një reagim më të shpejtë dhe të koordinuar ndaj emergjencave.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

TACION
PINIZMI

STËRVITJE NË STACIONIN E ALPINIZMIT

Efektivët e togës së kërkim-shpëtimit në Detashmentin e Mbrojtjes Rajonale, **Mengel**, në kuadër të përmirësimit të kapaciteteve operacionale për **ndërrhyrje** të shpejtë dhe **profesionale** në raste emergjencash civile, realizuan një stërvitje intensive në stacionin e **alpinizmit**. Gjatë stërvitjes, kryen **zbritje** me litar dhe hedhje nga lartësi, duke forcuar aftësitë **teknike** dhe fizike të domosdoshme për misionet e kërkim-shpëtimit.

★★★★★



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES



BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Ministri i Mbrojtjes, **Pirro Vengu**, priti në një takim ambasadorin e **Brazilit** në Shqipëri, Tabajara De Oliveira Júnior. Në qendër të bisedës ishte **forcimi** i bashkëpunimit mes dy **vendeve**, me theks të veçantë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

